




REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. <u>E-D / DPK</u> Nr. i faq. Broj stranica <u>02</u> Nr. pages	Nr. Prot. Br. Prot. <u>01-1370/2012</u> Prot No. Data Datum <u>17-04-2012</u> Date PRISHTINE



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 29 paragrafi 1 pika e) të Rregullores së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 04.04.2012, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr.AKK– 03-4799/11, për z.**Agim Kuleta, Deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës**, për shkak se Zyrtari i lartë publik ka shmangur gjendjen e konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Në rastin e shqyrtuar për konflikt të interesit me numër protokolli AKK–03-4799/11, qe ka të bëjë me z. Agim Kuleta, Deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës, janë zhvilluar të gjitha procedurat për të vërtetuar gjendjen e konflikt të interesit.

Pas zhvillimit të procedurës dhe analizimit të gjendjes është konstatuar se zyrtari i lartë publik, gjatë kohës se ushtrimit te funksionit Publik ka në pronësi dhe është i regjistruar ne Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve, si person i autorizuar ne Biznesin e tij familjar N.SH.G “X print” dhe në Biznesin tjetër N.SH “Fair –Play” ku është edhe pronarë dhe person i autorizuar, e që paraqet papajtueshmëri ne ushtrimin e funksionit Publik sipas Neni 15.1 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik Nr.04/L-051. Agjencia kundër Korrupsionit e ka njoftuar zyrtarin se ka filluar procedura e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të Konfliktit të Interesit dhe se ka të drejtë qe në afatin prej 15 ditësh të njoftohet me faktet dhe informatat që posedon Agjencia.

Pas këtyre procedurave zyrtari i lartë z. Agim Kuleta ka ardhur në Agjenci dhe e kemi informuar për faktet që disponon Agjencia lidhur me gjendjen e mundshme të Konfliktit të interesit.

Zyrtari i lartë z. Kuleta gjatë takimit është pajtuar për situatën mirëpo është arsyetuar se nuk ushtron pozitat në këto biznese por vetëm kanë mbetur të regjistruara dhe nuk janë azhurnuar në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve, dhe është zotuar se ne afatin ligjor do ti bëjë ndryshimet e kërkuara për të shmangur Konfliktin e mundshëm të Interesit.

Me datën 14.03.2012 zyrtari lartë z. Agim Kuleta ka sjellë dëshmitë nga ARBK-ja, se janë bërë ndryshimet e kërkuar dhe se nuk ushtron me funksione udhëheqëse ne biznes.

Andaj u vendos si në diapozitiv të këtij vendimi.

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Hasan Preteni
Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit

